

VENDIM
Nr. 410, datë 18.4.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 48, DATË 23.1.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KRIJIMIN E UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË (UMT), TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 12/1 e 41 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1 të kreut V “Organika dhe financimi”, të vendimit nr. 48, datë 23.1.2013 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Personeli i kualifikuar i qendrave spitalore universitare bëhet pjesë e organikës së personelit akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas njësive kryesore dhe atyre bazë. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë personeli i kualifikuar janë:

a) Rezultate të shkëlqyera (notë mesatare mbi 9) në studimet universitare, në studimet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë dhe titulli “Doktor”, për kandidatët që i kanë kryer këto studime brenda vendit, ose rezultate të mira (notë mesatare mbi 8) në studimet universitare të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë dhe titulli “Doktor”, për kandidatët që i kanë kryer këto studime jashtë vendit;

b) së paku 7 vite punë në qendra spitalore universitare apo në spital, pas përfundimit të specializimit.

Përkatësia në njësitë kryesore dhe ato bazë të UMT-së përcaktohet me vendim të Senatit Akademik dhe Këshillit të Administrimit të Universitetit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha